



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr.71/6 prot.

Tiranë, më 30.03.2026

V E N D I M

PARALAJMËRIMI

Nr. 25, datë 30.03.2026

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË, NË
LIDHJE ME VEPRIMET ADMINISTRATIVE TË KRYERA NGA ORGANET E
NGARKUARA NGA LIGJI GJATË ADMINISTRIMIT TË MARRËDHËNIES SË
PUNËSIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL, NË INSTITUCIONIN E BASHKISË
DIVJAKË DHE PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR TË RREGULLUAR
LIGJSHMËRINË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera nga organet e ngarkuara nga ligji gjatë administrimit të marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil, për nëpunësen Manuela Kolonjari, me detyrë “Përgjegjës Njësie”, në Njësinë e Integritimit European dhe Ndihmës së Huaj, në Bashkinë Divjakë,

VËREJ SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nëpërmjet informacionit të regjistruar me shkresat nr. 71 prot., datë 15.01.2026 dhe nr. 71/1 prot., datë 23.01.2026, të dërguar nga nëpunësja Manuela Kolonjari, me detyrë “Përgjegjës Njësie”, në Njësinë e Integritimit European dhe Ndihmës së Huaj, në Bashkinë Divjakë, është njohur me pretendimet e nëpunëses, për parregullsi të kryera në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil gjatë aplikimit të instituteve të ligjit të shërbimit civil.

Konkretisht, në përmbajtje të informacionit dhe të dokumentacionit të administruar bashkëlidhur tij, nëpunësja parashtron se, organet e ngarkuara nga ligji me detyra specifike gjatë administrimit të shërbimit civil, kanë lejuar shkelje të ligjit të shërbimit civil dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të këtij, në këto drejtime:

Së pari, gjatë procedurës së dhënies së masës disiplinore “*Vërejtje*”, në ngarkim të saj, në informacionin e dërguar, nëpunësja parashtron se, motivacioni për shkelje të disiplinës në punë, për të cilin ka nisur edhe ecuria disiplinore, është ngritur mbi akuza të pavërteta dhe të paargumentuara nga Kryetari i Bashkisë Divjakë, e për pasojë, masa disiplinore e dhënë në ngarkim të saj, është në kundërshtim me kërkesat e parashikuara nga legjislacioni që rregullon institutin e disiplinës në shërbimin civil.

Së dyti, sa i takon vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën e vlerësimit Janar-Qershor dhe Korrik-Dhjetor, për vitin 2024, nëpunësja pretendon se, nuk i është dhënë vlerësimi për këto periudha, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil”, të ndryshuar.

Së treti, në lidhje me procesin e ristrukturimit në Bashkinë Divjakë, nëpunësja në fjalë pretendon se nuk është njoftuar në kohë mbi procesin e ristrukturimit të institucionit.

Në këto kushte, ajo ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga subjekte të ligjit, të evidentuara si më lart.

Me qëllim verifikimin e rastit, me marrjen e këtij informacioni, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11 dhe nenin 14, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, pasi u njoh me pretendimet e parashtruara nga nëpunësja Manuela Kolonjari, filloi procesin e verifikimit të informacionit nëpërmjet shkresës nr. 71/2 prot., datë 02.02.2016, “*Kërkesë për dokumentacion në lidhje verifikimin e informacioneve që janë dërguar pranë Komisionerit me shkresat nr. 71 prot., datë 15.01.2026 dhe 71/1 prot., datë 23.01.2026, nga nëpunësja Manuela Kolonjari*”, duke vënë në dijeni institucionin për fillimin e verifikimit të këtyre procedurave disiplinore, duke i kërkuar dokumentacionin në të cilin janë materializuar ato.

Në përgjigje të kësaj kërkesë Bashkia Divjakë, me shkresën nr. 391/3 prot., datë 10.02.2026, me objekt: “*Kthim përgjigje kërkesës për dokumentacion*”, e protokolluar pranë Komisionerit me shkresën nr. 71/3 prot., datë 13.02.2026, ka dërguar një pjesë të dokumentacionit të kërkuar, si aktet e emërimit, aktin e deklaramentit të statutit të nëpunësës M. Kolonjari, strukturën e institucionit, materialet shkresore që lidhen me ecurinë disiplinore, por nuk rezulton të na jenë vënë në dispozicion aktet e vlerësimit të kësaj nëpunëse për vitin 2024.

Nga përmbajtja e dokumentacionit të administruar nga Komisioneri, rezulton se, me vendimin e emërimit nr. 3112/14 prot., datë 15.12.2023, të njësisë së burimeve njerëzore, nëpunësja M. Kolonjari, është emëruar në pozicionin e punës “Përgjegjëse”, në Sektorin e Njësisë së Integritit European dhe Ndihmës së Huaj në Bashkinë Divjakë.

Në kuadrin e vlerësimit të ligjshmërisë së procedurave të ndjekura në rastin e nëpunësës M. Kolonjari, evidentohet se janë kryer veprimet si më poshtë:

1. Përsa i përket procedurës disiplinore, rezulton se, njësia e burimeve njerëzore në Bashkinë Divjakë, në datën 22.12.2025, ka monitoruar prezencën e punonjësve gjatë orarit zyrtar, duke ushtruar kontroll në Administratën Qendrore të Bashkisë dhe të Agjencisë së Shërbimeve, përkatësisht në tre intervale kohore, materializuar në akt-konstatimin nr.13012 prot., datë 22.12.2025.

Gjatë kontrolleve të kryera është konstatuar se, nëpunësja M. Kolonjari, nuk ndodhej në vendin e saj të punës dhe nuk kishte njoftuar eprorin e saj direkt për këtë fakt.

Nisur nga sa më sipër, me aktin nr. 13140 prot., datë 29.12.2025, “Njoftim për fillimin e procedurës së shqyrtimit disiplinor dhe kërkesë për paraqitjen e shpjegimeve”, të titullarit të institucionit, nëpunësja është njoftuar se ndaj saj ka nisur procedura e disiplinore me motivacionin: “Shkelje e disiplinës në punës, mungesë pa njoftim paraprak”, të parashikuar në nenin 57, pika 4, germa b), duke i lënë 5 ditë kohë nëpunësës për të paraqitur shjegimet me shkrim dhe për tu dëgjuar.

Në lidhje me këtë njoftim, nëpunësja me shkresën e datës 30.12.2025, “Kthim përgjigje shkresës së Kryetarit të Bashkisë Divjakë me nr. 13140 prot., datë 29.12.2025”, ka parashtruar se, procedimi disiplinor i nisur në ngarkim të saj është i paligjshëm, duke qenë se, mungesa e saj në punë ishte e arsyeshme dhe plotësisht e justifikuar, pasi në këtë datë ka qenë e pajisur me raport paaftësie në punë, për periudhën nga data 22.12.2025 deri në datën 05.01.2026, për arsye të kujdesit ndaj fëmijës së saj pas një ndërhyrje kirurgjikale, (dërguar për efekt prove, me foto raporti i mjekut lëshuar për fëmijën nga QSUT-ja.)

Më tej, nëpunësja sqaron se në lidhje me mungesën në datën 22.12.2025, ka njoftuar paraprakisht titullarin e institucionit dhe më pas njësinë e burimeve njerëzore të Bashkisë Divjakë, ndërsa raportin mjekësor e ka dorëzuar në institucion në datën 23.12.2025.

Në vijim, konstatohet se nëpërmjet aktit nr. 13140/2 prot., datë 31.12.2025, “Relacion vlerësues mbi konstatimet dhe shkeljen disiplinore”, të njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Divjakë, janë parashtruar faktet dhe rrethanat e gjetura në rastin e nëpunësës M. Kolonjari, janë vlerësuar elementët e shkeljes disiplinore dhe në përfundim i është propozuar titullarit të institucionit, dhënia e masës disiplinore “Vërejtje”, në ngarkim të nëpunësës në fjalë.

Më tej, Kryetari i Bashkisë Divjakë, me vendimin nr. 13 datë 12.01.2026, ka dhënë masën disiplinore “Vërejtje”, në ngarkim të nëpunëses M. Kolonjari, me motivacionin: shkelje të disiplinës dhe rregullave të etikës në punës, parashikuar në nenin 57, pika 4, germa b), të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Sa i takon ligjshmërisë së dhënies së kësaj mase disiplinore, vlerësojmë se duhet të analizohet baza ligjore që e rregullon këtë institut të ligjit.

Konkretisht, në nenin 57, “Përgjegjësia për masat disiplinore”, përcaktohet përgjegjësia e nëpunësit civil për shkeljen me faj të detyrimeve sipas ligjit, si edhe kategorizimi i shkeljeve në:

a) shkelje shumë të rënda; b) shkelje të rënda; c) shkelje të lehta.

Më tej, në pikën 2, të këtij neni, parashikohet kategorizimi i shkeljeve shumë të rënda; në pikën 3, i shkeljeve të rënda dhe në pikën 4, i shkeljeve të lehta.

Ndërsa, në nenin 58, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, parashikohen “Llojet e masave disiplinore” të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, në një rast kur evidentohen shkelje disiplinore:

“Masat disiplinore që mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil janë:

a) vërejtje;

b) mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj;

c) pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet.

ç) largim nga shërbimi civil”,

dhe në nenin 59, të këtij ligji, përcaktohet kompetenca dhe procedura për dhënien e tyre. Sipas pikës 2, të kësaj dispozite, masa e parashikuar në germën a) të nenit 58, jepet nga eprori direkt i nëpunësit, ndërsa masat e parashikuara në germat b), c) dhe ç) jepen nga Komisioni Disiplinor, për çdo nëpunës civil në institucion.

Në referim të pikës 10, të nenit 59, të ligjit në fjalë, është parashikuar se, Këshilli i Ministrave miraton me vendim rregullat e hollësishtme të procedurës disiplinore, si dhe rregullat për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor. Ky detyrim ka gjetur zbatim me miratimin e Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”, i ndryshuar.

Konkretisht, në aktin nënligjor që rregullon disiplinën në shërbimin civil, (VKM nr.115/2014), në kreun I “Organet Disiplinore”, pika 1, përcaktohet se:

“Organet disiplinore, sipas ligjit, janë: Komiteti Kombëtar i Përzgjedhjes, për anëtarët e TND-së (KKP); komisioni disiplinor (KD), për nëpunësit e tjerë, dhe eprori direkt”.

Sa i takon procedurës që duhet të ndiqet nga ana e organeve disiplinore, në rastin konkret, nga ana e eprorit direkt, pikat 13 deri 20, të aktit nënligjor në fjalë, parashikojnë të gjitha veprimet administrative që duhet të kryhen, për nisjen e ecurisë disiplinore nga eprori direkt, kur shkelja disiplinore konsiderohet e lehtë: njoftimin me shkrim të nëpunësit, duke e njohur me faktin e pretenduar si shkelje disiplinore; faktet dhe provat e mbledhura gjatë procedimit disiplinor në ngarkim të tij; si dhe duke i dhënë mundësi nëpunësit të mbrohet, të paraqesë prapësimet dhe prova për të provuar se nuk ka kryer ndonjë shkelje disiplinore me faj.

Vetëm në përfundim të këtij procesi, eprori direkt në mbështetje të të gjithë akteve të administruara gjatë procedurës së hetimit disiplinor, duhet të marrë një vendim të argumentuar, të mbështetur në prova, nëse nëpunësi e ka kryer ose jo shkeljen dhe në rastet kur ekziston elementi i fajësisë për shkeljen e kryer, jepet masa disiplinore.

Kjo procedurë që duhet të ndiqet gjatë ecurisë disiplinore, në mënyrë edhe me të detajuar për secilën fazë të saj parashikohet në Udhëzimin nr. 1, datë 21.01.2025, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për organet disiplinore dhe procedurën e shqyrtimit të shkeljeve disiplinore*”, të cilit organi i disiplinës duhet ti referohet për analogji.

Në mbështetje të dokumentacionit të administruar për hetimin e këtij rasti, sa i takon aspektit procedural konstatohet se, masa disiplinore “*Vërejtje*” për nëpunësen e proceduar M. Kolonjari, është dhënë nga Kryetari i Bashkisë, në mungesë të kompetencës lëndore. Organi kompetent për ndjekjen e procedurës disiplinore në rastin e shkeljeve të klasifikuara “*të lehta*”, në mbështetje të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, është eprori direkt i nëpunëses në procedim dhe dhënia e kësaj mase disiplinore është në diskrecion të tij.

Në analizë të strukturës organizative të bashkisë, eprori direkt i nëpunëses M. Kolonjari, e emëruar në pozicionin e punës “*Përgjegjëse*”, në Sektorin e Njësisë së Integritimit European dhe Ndihmës së Huaj, në Bashkinë Divjakë, është **Sekretari i Përgjithshëm**. Ky zyrtar është ngarkuar nga ligji edhe për vlerësimin dhe klasifikimin e shkeljeve disiplinore të pretenduara, në referim të kreut II, të Udhëzimit nr. 01, datë 21.01.2025, “*Për organet disiplinore dhe procedurën e shqyrtimit të shkeljeve disiplinore*”, të DAP-it.

2. Sa i përket procedurës së ndjekur për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunëses M. Kolonjari, vlerësimi i së cilës është një aspekt tjetër i hetimit administrativ, për periudhën e vlerësimit Janar- Qershor dhe Korrik- Dhjetor për vitin 2024, rezulton se, me aktin nr. 492 prot., datë 20.01.2026, “*Kthim përgjigje kërkesës për informacion mbi vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2024*”, të Sekretarit të Përgjithshëm, nëpunësja është njoftuar se nuk është kryer procedura e vlerësimit të rezultateve në punë, për periudhën e vlerësimit Janar- Qershor dhe Korrik- Dhjetor për vitin 2024, nga personat e ngarkuar me ligj, duke dhënë argumente të cilat vlerësohen si të pambështetura në ligj.

Në këtë rast, njësia e burimeve njerëzore e institucionit, si dhe zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit duhet të tregojnë kujdes për kryerjen e këtij procesi, pasi vlerësimi i rezultateve në punë është veprim i rëndësishëm, i cili i shërben verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuara në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave. Vlerësimi i performancës në punë ka pasoja të rëndësishme për një nëpunës civil dhe shërben për të marrë vendime objektive edhe në lidhje me periudhën e provës, ngritjen në detyrë, lirimimin nga shërbimi civil, si dhe në përcaktimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim profesional të nëpunësit civil.

Nisur nga përmbajtja e vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, akt i cili ka dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 62, të ligjit 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, rezulton se, në të është përcaktuar me hollësi procedura e vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë dhe kompetencat për vlerësimin. Formulari i vlerësimit të punës, duhet të hartohet sipas formatit të miratuar në Lidhjen nr. 2, pjesë e këtij vendimi.

Megjithatë ndodhur në kushtet kur, pas periudhës së vlerësimit Janar- Qershor dhe Korrik-Dhjetor për vitin 2024, janë kryer dy vlerësime të njëpasnjëshme për periudhën Janar-Qershor dhe Korrik- Dhjetor për vitin 2025, hartimi dhe miratimi i vlerësimeve të mëparshme, nuk sjell efekte ligjore në marrëdhënien e punës së nëpunëses së vlerësuar.

Por, nga ana tjetër sjellim në vëmendje të zyrtarëve raportues të cilët janë të përfshirë në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, se kanë përgjegjësi ligjore për të respektuar të gjitha procedurat e hollësishme të përcaktuara në vendimin nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar.

3. Në lidhje me pretendimin e nëpunëses M. Kolonjari, se ajo nuk është njoftuar në kohë mbi procesin e ristrukturimit të institucionit të Bashkisë Divjakë, nga përmbajtja e dokumentacionit të administruar nga Komisioneri, rezulton se, kjo bashki ka kaluar në proces ristrukturimi, bazuar në urdhrin nr. 532, datë 15.12.2025, “*Për miratimin e strukturës/organikës dhe kategoritë e pagave të Bashkisë Divjakë dhe ndërmarrjeve vartëse për vitin 2026*”, të titullarit të institucionit.

Në vijim, me shkresën nr. 248 prot., datë 12.01.2026, “*Njoftim mbi procesin e ristrukturimit të institucionit Bashkia Divjakë*”, të njësisë përgjegjëse, nëpunësja M. Kolonjari është njoftuar për fillimin e procesit të ristrukturimit të institucionit.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, njësia e burimeve njerëzore të Bashkisë Divjakë, në aktin nr. 60 prot., datë 06.01.2026, “*Relacion*”, ka parashtruar se, e ka pasur të pamundur kryerjen e njoftimit të nëpunësve brenda afatit ligjor, pasi struktura e re ka hyrë në fuqi në datën 01.01.2026, datë e cila përkon me festat zyrtare, ndërkohë që, edhe nëpunësja e prekur nga ristrukturimi M. Kolonjari ka qenë me raport mjekësor nga datat

06.01.2006 deri në datën 10.01.2026, ç'ka përbën një pamundësi objektive për kryerjen e njoftimit në kohë.

Me urdhrin nr. 30, datë 14.1.2026, “Për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit, në kudër të *ristrukturimit*”, të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Divjakë, është ngritur Komisioni i Ristrukturimit.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, përpara procesit të ristrukturimit nëpunësja M. Kolonjari, me aktin nr. 3112/14 prot., datë 15.12.2023, të njësisë së burimeve njerëzore ka qenë e emëruar në pozicionin e punës “Përgjegjëse”, në Sektorin e Njësisë së Integritit Europian dhe Ndihmës së Huaj, klasa e pagës III-3.

Pas përfundimit të procesit të ristrukturimit në bashki, Komisioni i Ristrukturimit me vendimin nr. 23, datë 27.01.2026, “Për propozimin e transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë në kuadër të ristrukturimit”, ka vendosur transferimin e përhershëm të nëpunëses M. Kolonjari në pozicionin “Koordinator i Integritit Europian dhe Ndihmës së Huaj”, klasa e pagës IV-3, si pasojë e suprimimit të pozicionit “Përgjegjës”, në Sektorin e Njësisë së Integritit Europian dhe Ndihmës së Huaj.

Në vijim, me aktin nr. 326/3 prot., datë 04.02.2026, të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, nëpunësja Manuela Kolonjari është transferuar në pozicionin “Koordinator i Integritit Europian dhe Ndihmës së Huaj”, në Bashkinë Divjakë, klasa e pagës IV-3, pozicion në të cilin nëpunësja **nuk ka shprehur pëlqimin**.

Referuar dispozitave të cilat rregullojnë institutin e transferimit të përhershëm në shërbimin civil, rezulton se, në pikën 1, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar, parashikohet se:

“1. Nëse për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, pozicioni i mëparshëm i një nëpunësi civil nuk ekziston më, ai transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori;

.....”.

Në rastin e transferimit të nëpunëses M. Kolonjari, konstatohet se nuk janë respektuar kërkesat e parashikuara në këtë dispozitë të ligjit, pasi nëpunësja është transferuar në një pozicion pune në një kategori më të ulët në shërbimin civil, nga kategoria III, në kategorinë IV-3.

Ndërkohë, gjatë procesit të verifikimit të rastit, Komisioneri është informuar nga ana e institucionit të Bashkisë Divjakë, se nëpunësja në fjalë, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, për zgjidhjen e çështjes, proces i cili është në vijim. Pranë Komisionerit është dërguar nga institucioni “Njoftim padia” me nr. akti. 1804, datë regjistrimi 27.02.2026, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, dhe

kërkesëpadia e paditëses Manuela Kolonjari, me palë të paditur institucionin e Bashkisë Divjakë, me objekt:

1. *“Shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ vendimit nr. 13, datë 12.01.2026, të Kryetarit të Bashkisë Divjakë, “Për dhënien e masës disiplinore vërejtje, ndaj paditëses Manuela Kolonjari”, si akt administrative i kundërligjshëm;*
2. *Heqjen e masës disiplinore nga dosja personale e paditëses Manuela Kolonjari”.*

Nisur nga gjithë sa më sipër, bazuar në parimin e sanksionuar në nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996, *“Kodi i Procedurës Civile”* i ndryshuar, në përmbajtje të së cilit sanksionohet se, asnjë institucion tjetër shtetëror nuk mund të trajtojë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësojmë se, Komisioneri nuk mund të vijojë më tej, procedurën e hetimit të kësaj procedure disiplinore, pasi kjo mosmarrëveshje është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor, në përfundim të së cilit do të jepet zgjidhje përfundimtare pas trajtimit në themel të rastit.

Sa i takon aktit nr. 326/3 prot., datë 04.02.2026, të nxjerrë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, me anë të së cilit nëpunësja Manuela Kolonjari është transferuar në pozicionin *“Koordinator i Integritetit Europian dhe Ndhmës së Huaj”*, në Bashkinë Divjakë, klasa e pagës IV-3, në përfundim të procesit të ristrukturimit të institucionit, në zbatim të gërmes d), të nenit 109, të Kodit të Procedurave Administrative, është një akt i nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 113, të këtij kodi, organi publik që e ka nxjerrë atë duhet ta anullojë, duke shqyrtuar mundësinë e sistemimit të nëpunëses në pozicionet e lira ku ajo i plotëson kërkesat e përcaktuara.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të Ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, i ndryshuar; nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996, *“Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar dhe nenin 16, pika 6), e Rregullores *“Për procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ dhe arkivimin e çështjes, të filluar në bazë të informacionit të regjistruar me shkresat nr. 71 prot., datë 15.01.2026 dhe nr. 71/1 prot., datë 23.01.2026, përsa i takon objektit të kërkuar për vlerësimin e ligjshmërisë së procedurës së ndjekur për dhënien e masës disiplinore, në ngarkim të nëpunëses

Manuela Kolonjari, pasi mosmarrëveshja është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe do të zgjidhet në themel nga gjykata kompetente.

2. Sa i takon transferimit të përhershëm të nëpunëses, njësia përgjegjëse, duhet të konstatojë paligjshmërinë e aktit nr. 326/3 prot., datë 04.02.2026, për transferimin e përhershëm të nëpunëses M. Kolonjari, në pozicionin “*Koordinator i Integritetit European dhe Ndihmës së Huaj*”, në Bashkinë Divjakë, klasa e pagës IV-3.
 - Komisioni i Ristrukturimit duhet të kryejë një rivlerësim të plotë të mundësive për sistemimin e nëpunëses, në institucionin e Bashkisë Divjakë, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësit civil*”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 17.02.2016, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, në një pozicion pune brenda të njëjtës kategori ku nëpunësja plotëson kriteret e posaçme, duke ndjekur veprimet e parashikuara në pjesën arsyetuese të relacionit.
3. Njësia përgjegjëse, pranë institucionit të Bashkisë Divjakë duhet të ndjekë ecurinë e procesit administrativ, për kryerjen e veprimeve të mësipërme.
4. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat **15** ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
5. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
6. Të njoftohet për këtë vendim institucioni Bashkia Divjakë, si dhe nëpunësja Manuela Kolonjari.
7. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)